



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës
Opština Priština –Municipality of Prishtina

Në mbështetje të nenit 52, paragrafi 52.1 i Ligjit nr. 03/L - 040, për vetëqeverisje lokale, (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës”, nr. 28/15, qershor 2008), të nenit 45, paragrafi 45.2 i Statutit të Komunës së Prishtinës, 01 nr. 110 - 391, të dt. 25.2.2010 dhe të nenit 4, pika 4.3 e Rregullores për procedurën e themelimit, përbërjen dhe kompetencat e komiteteve të përhershme në Komunën e Prishtinës, kryesuesi i Komitetit për Politikë dhe Financa të Komunës së Prishtinës,

th ë r r e t

mbledhjen e **shtatë** të Komitetit për Politikë dhe Financa, e cila do të mbahet më **12.12.2016**, dhe do të fillojë në orën **15:00**.

Mbledhja do të mbahet në sallën e Këshillit të Drejtorëve (kati II) të Komunës së Prishtinës.

Për mbledhje propozon këtë

REND TË DITËS:

1. Miratimi i ekstraktit të procesverbalit të mbledhjes së gjashtë të Komitetit për Politikë dhe Financa;
2. Propozimvendimi për lënien në diskutim publik të Rregullores për organizimin dhe bashkëpunimin e Komunës me fshatrat, vendbanimet dhe lagjet urbane në territorin e komunës së Prishtinës;
3. Shqyrtimi i Raportit të auditimit të përgjithshëm për vitin 2015;
4. Caktimi i një anëtari në Komisionin Komunal të Aksionarëve në NPL “Hortikultura” SHA dhe NPK “Trafiku Urban” SHA Prishtinë;
5. Propozimvendimi për rikategorizimin e parkut rajonal natyror “Gërmia” në kategorinë - peizazh i mbrojtur;
6. Propozimvendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës me pronën e paluajtshme në pronësi të personave fizik/juridik;
7. Propozimvendimi për themelimin e grupit punues të Kuvendit të Komunës për hartimin e planit të punës së Kuvendit për vitin 2017;
8. Propozimvendimi për ndryshimin e vendimit për Komitetin për komunitete;
9. Të ndryshme.

KRYESUESI I KOMITETIT

Halim Halimi, jur. i dipl.

Vërejtje: Luteni që të merrni pjesë në mbledhje. Në rast pamundësie për të marrë pjesë, lajmërohuni në Shërbimin e Kuvendit, në tel. kontaktues: 038/230-900, lok. 1100.